


# ANALIZË E MEDIAVE: PROPAGANDA E IRANIT NË GJUHËN SHQIPE





ANALIZË E MEDIAVE:

**PROPAGANDA E IRANIT NË  
GJUHËN SHQIPE**

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative (BIRN Albania)  
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë  
<http://birn.eu.com/>

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)  
Rr. Muhamet Gjollësia, Nr. 9, Tiranë  
<https://scidevcenter.org/>

Authors: Blerjana Bino  
Besar Likmeta

Analiza e të dhënave: Jesmina Sengla

Përktheu në shqip: Durim Tabaku

Arti grafik: Jurgena Tahiri

© Balkan Investigative Reporting Network in Albania dhe Science &  
Innovation for Development  
Tirana, 2023



Ky raport u financua nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Opinionet, gjetjet, përfundimet apo rekomandimet e shprehura në të janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

## I. Hyrje 7

Roli i Iranit në Ballkanin Perëndimor 8

Roli i Iranit në Shqipëri 10

Shënime për metodologjinë 13

## II. Gjetje 14

Tematikat kryesore 14

Nga bota 15

Gjeopolitikë 16

Ushtri dhe siguri 17

Politikë dhe kulturë iraniane 18

Tematika të përzgjedhura 19

Bashkimi Evropian 20

Të drejtat e njeriut 20

Organizata Mujahedin-e-Khalq (MEK) 21

## III. Përfundime dhe rekomandime 23



# I. Hyrje

Ndikimi i Iranit në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet ndërveprimeve konvencionale politike dhe ekonomike është modest. Gjithsesi, angazhimi i tij në rajon me anë të përfaqësive, operacioneve të inteligjencës dhe grupeve mbështetëse të opozitës nënkupton rëndësinë që ka rajoni në strategjinë globale të Iranit.<sup>1</sup> Ndonëse mundësia që rajoni të shërbejë si bazë për konfliktet e ardhshme mes përfaqësive të Iranit dhe Perëndimit duket i pamundur, ka një aspekt që kërkon analizë të kujdesshme, duke pasur parasysh rritjen e rëndësisë strategjike të rajonit për Iranin.

Marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe Iranit që u vendosën në vitin 1999 kanë qenë historikisht të ndërlikuara dhe, kohët e fundit, mjaft të tensionuara. Irani është përpjekur të shtrijë ndikimin e tij kulturor në Shqipëri nëpërmjet aktiviteteve të tilla si financimi i botimeve fetare dhe letrare dhe krijimi i shoqatave aktive iraniane. Megjithatë, marrëdhëniet u përkeqësuan ndjeshëm kur Shqipëria akuzoi Iranin si autor të një sulmi masiv kibernetik të ndërmarrë ndaj infrastrukturës së saj digjitale në verën e vitit 2022. Sulmi, që dyshohet se u krye nga katër grupe të lidhura me Iranin, kishte për qëllim të dëmtonte shërbimet publike, të vidhte të dhëna dhe të merrte në kontroll komunikimet e qeverisë. Akuzat e Shqipërisë u mbështetën nga gjetjet e Microsoft-it dhe për këtë incident NATO-ja, SHBA-të, BE-ja dhe Britania e Madhe shprehën solidaritetin e tyre me Shqipërinë.

Një tjetër çështje serioze që çon në mosmarrëveshjeje mes dy vendeve është strehimi nga Shqipëria i Muxhahedinëve El-Khalq (MEK), një grup opozitar iranian që synon të rrëzojë qeverinë teokratike të Iranit. Me rreth 3,000 anëtarë të MEK-ut të vendosur aktualisht në kampin Ashraf-3 në Shqipëri, Irani e konsideron mbështetjen e Shqipërisë për këtë grup si provokim të drejtpërdrejtë. Prania e

---

<sup>1</sup> "Ndikimet gjeopolitike të fuqive të jashtme në Ballkanin Perëndimor", 2021, gjendet në adresën [https://hcss.nl/wp-content/uploads/2021/01/Geopolitical-Influences-of-External-Powers-in-the-Western-Balkans\\_0.pdf](https://hcss.nl/wp-content/uploads/2021/01/Geopolitical-Influences-of-External-Powers-in-the-Western-Balkans_0.pdf) aksesuar më 31.03.2023.

MEK-ut, e kombinuar me incidentin e fundit të sulmit kibernetik, ka përshkallëzuar tensionet mes dy shteteve, që duket se ndikon në peizazhin e gjerë gjeopolitik dhe te negociatat e vazhdueshme për programin bërthamor të Iranit.

Në këtë kuadër, analizimi i diplomacisë publike të Iranit në Shqipëri përmes mediave të tij të sponsorizuara nga shteti është një detyrë e rëndësishme dhe e kohës, veçanërisht duke qenë se lufta e informacionit përbën një komponent kryesor të strategjisë moderne gjeopolitike. Në kontekstin e përshkallëzimit të tensioneve mes Shqipërisë dhe Iranit, kjo analizë e propagandës së Iranit është një hap tejte i rëndësishëm për të kuptuar ndikimin dhe synimet e këtij të fundit.

Në këtë analizë ofrohen opinione të vlefshme për taktikat e diplomacisë publike të Iranit dhe fushat e fokusit, përfshirë këtu qëndrimin e tij ndaj Organizatës Mujahedin-e-Khalq (MEK), Bashkimit Evropian dhe tematika të tjera me interes. Për më tepër, duke qenë se fushatat e disinformimit dhe propagandës mund të ndikojnë ndjeshëm në opinionin publik dhe potencialisht të destabilizojnë shoqëritë, studimi i këtyre mesazheve përbën një aspekt themelor për sigurinë kombëtare dhe ndërjegjësimin e publikut. Pavarësisht nivelit të ulët të ndërveprimit në mediat sociale për përmbajtjen në gjuhën shqipe të Pars Today, është e rëndësishme të merren parasysh këto mesazhe në kontekstin më të gjerë të aktiviteteve diplomatike të Iranit dhe strategjisë së tij të diplomacisë publike.



## **Roli i Iranit në Ballkanin Perëndimor**

---

Marrëdhëniet e Iranit me vendet e Ballkanit Perëndimor i kanë filluar që nga vendosja e marrëdhënieve mes Iranit dhe Jugosllavisë në Lëvizjen e Shteteve të Paangazhuara, por ndikimi i tij i vërtetë në rajon filloi gjatë luftës së Bosnjës për pavarësi nga Jugosllavia, ku Irani u përfshi në dërgimin e armatimeve dhe trupave të vullnetarëve për të mbështetur liderin boshnjak Alija



Izetbegovic, i cili kishte krijuar lidhje me Iranin që pas Revolucionit Islamik.<sup>2</sup>

Interesi i Iranit për të zgjeruar ndikimin e tij në Ballkanin Perëndimor i atribuohet faktorëve fetarë, ideologjikë dhe gjeopolitikë. Ndryshimi i dinamikave e Ballkanit Perëndimor dhe rritja e ndikimit të aktorëve të jashtëm si Turqia, Shtetet e Gjirit Persik dhe Irani, hedhin dritë mbi fillimin e përdorimit të fesë si mjet për fuqinë e butë dhe realpolitikën. Ndërkohë që këta aktorë e ndërthurin Islamin në strategjitë e politikës së tyre të jashtme, në rajon po përjetohet një zhvillim i peizazhit gjeopolitik të ndërthurur me diplomacinë fetare. Roli i Iranit në këtë ekuacion meriton ende vëmendje, ndonëse ky rol nuk është aq i theksuar sa ai i Turqisë apo i Shteteve të Gjirit.

Nga pikëpamja ideologjike, Irani synon të përhapë në mbarë botën revolucionin e tij islamik. Përveç se lidhet me universalitetin e Islamit si besim, shtrirja e revolucionit është e vetmja mënyrë që revolucioni iranian të mund të mbijetojë.<sup>3</sup> Në epokën e viteve pas 1990, ndërveprimi i fesë dhe politikës është bërë edhe më i theksuar në rajon, i formuar ndjeshëm nga ndikimi i këtyre aktorëve të jashtëm. Ndryshe nga Turqia, që ka lidhje historike me Ballkanin përmes së kaluarës së përbashkët osmane, qasja e Iranit ndaj rajonit ka qenë më e zbutur dhe më pak e dukshme. Gjithsesi, përdorimi i fesë si instrument i politikës së jashtme është tematikë e zakonshme që vlen edhe për Iranin, që ndërthur elementë të diplomacisë kulturore me realpolitikën.<sup>4</sup>

Lidhjet ekonomike të Iranit me Ballkanin hasin disa pengesa. Si komb revolucionar, ideologjia është faktor përcaktues i qëndrimit të Iranit, shpesh duke lënë në hije konsideratat strategjike në angazhimet e tij ekonomike. Teherani nuk ka një strategji të mirë-përcaktuar për diplomacinë

---

<sup>2</sup> "Ndjekja e Iranit për fuqi të butë në Ballkan", 2022, gjendet në adresën <https://thecradle.co/article-view/21690/irans-pursuit-of-soft-power-in-the-balkans>, aksesuar më 31.03.2023.

<sup>3</sup> Maria Eleni Koppa (2021) Turqia, Shtetet e Gjirit dhe Irani në Ballkanin Perëndimor: më shumë se faktori islamik?, Revista e Studimeve Bashkëkohore Evropiane, 29:2, 251-263, DOI: [10.1080/14782804.2020.1754769](https://doi.org/10.1080/14782804.2020.1754769)

<sup>4</sup> Maria Eleni Koppa (2021) Turqia, Shtetet e Gjirit dhe Irani në Ballkanin Perëndimor: më shumë se faktori islamik?, Revista e Studimeve Bashkëkohore Evropiane, 29:2, 251-263, DOI: [10.1080/14782804.2020.1754769](https://doi.org/10.1080/14782804.2020.1754769)

ekonomike që të jetë në linjë me përparësitë dhe nevojat e veçanta ekonomike të secilit rajon. Rrjedhimisht, këta faktorë kontribuojnë në kompleksitetin e marrëdhënieve ekonomike të Iranit me Ballkanin Perëndimor. Serbia dallohet nga vendet e Ballkanit Perëndimor për lidhjet më të gjera ekonomike me Iranin. Konflikti në Ukrainë, dhe ndërprerja më vonë e furnizimit me naftë ruse në Evropë, e kanë bërë Serbinë të kërkojë burime alternative për naftë dhe plehra kimike, duke iu drejtuar Iranit. Në këmbim, Serbia planifikon të eksportoje grurin e saj në Iran.<sup>5</sup>

Nga pikëpamja strategjike, prania e Iranit në rajon vlen të përmendet edhe për implikimet e tij të mundshme. Irani dihet se e ushtron fuqinë e tij të butë në mënyrë strategjike, shpesh duke ofruar mbështetje dhe udhëzime për grupe dhe fraksione të ndryshme politike nëpërmjet përfaqësive. Gjithsesi, ndikimi i Iranit në Ballkanin Perëndimor mbetet modest kur bëhet fjalë për levat tradicionale të pushtetit, si ekonomia, politika apo fuqia ushtarake.<sup>6</sup> Pavarësisht kësaj, pozicionimi strategjik i Iranit në botë, duke shërbyer si urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit, shtrihet natyrshëm në Ballkanin Perëndimor. Vihet re një rritje e veprimtarive kulturore dhe fetare të Iranit në rajon, me gjasë si kundërveprim ndaj aktiviteteve në terren të BE-së dhe SHBA-ve dhe si rreshtim strategjik me aktorët që ushqejnë ndjenja anti-perëndimore. Kështu, rajoni shfaqet si zonë me interes strategjik për Iranin.



## Roli i Iranit në Shqipëri

---

Shqipëria dhe Irani vendosën marrëdhëniet zyrtare në vitin 1999. Në kontekstin shqiptar, Irani

<sup>5</sup> "Ndjekja e Iranit për fuqi të butë në Ballkan", 2022, gjendet në adresën <https://thecradle.co/article-view/21690/irans-pursuit-of-soft-power-in-the-balkans>, aksesuar më 31.03.2023.

<sup>6</sup> "Ndikimet gjeopolitike të fuqive të jashtme në Ballkanin Perëndimor", 2021, gjendet në adresën [https://hcss.nl/wp-content/uploads/2021/01/Geopolitical-Influences-of-External-Powers-in-the-Western-Balkans\\_0.pdf](https://hcss.nl/wp-content/uploads/2021/01/Geopolitical-Influences-of-External-Powers-in-the-Western-Balkans_0.pdf) aksesuar më 31.03.2023.

është përpjekur të zhvillojë ndikimin e tij në fushën e kulturës, filozofisë dhe letërsisë, duke financuar botime me përmbajtje kryesisht fetare të sektit shiit si dhe botime nga poetë shqiptarë që kanë shkruar në persisht. Dy shoqatat më aktive iraniane në vend janë Fondacioni Kulturor Saadi Shirazi dhe Shoqata Kulturore dhe Fetare Flladi, e krijuar për të zëvendësuar Shoqatën Fetare “Kuran”, e cila në vitin 2005 u detyrua të mbyllej. Fondacioni Kulturor Saadi Shirazi boton kryesisht klasikë persianë si dhe autorë shqiptarë që kanë shkruar në persisht.<sup>7</sup> Ajo që bie në sy, veçanërisht në botimet letrare, është se ato shpesh nxirren jashtë kontekstit osman në të cilin janë shkruar dhe vishen me referenca të Revolucionit Iranian. Kjo duket si përpjekje për të krijuar lidhje artificiale mes kulturës shqiptare dhe asaj iraniane si dhe për të shpërndarë mesazhe pozitive për frymën aktuale politike të Iranit.

Më 7 shtator 2022, kryeministri Edi Rama njoftoi ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit. Ky vendim erdhi pas akuzave se Teherani orkestroi sulmin kibernetik në shkallë të gjerë ndaj infrastrukturës digjitale të Shqipërisë më 15 korrik 2022. Rama deklaroi se sulmin e kishin kryer katër grupe të lidhura me Iranin, me qëllim paralizimin e shërbimeve digjitale publike të vendit, vjedhjen e të dhënave dhe marrjen në kontroll të komunikimeve të qeverisë. Këto akuza u konfirmuan nga firma amerikane e sigurisë kibernetike Microsoft<sup>8</sup>, e cila konstatoi se hakerat iranianë kishin depërtuar në rreth 10% të rrjetit digjital qeveritar që nga muaji maj 2021. Incidenti nxiti mbështetjen zyrtare për Tiranën nga NATO-ja, SHBA-të, BE-ja dhe Britania e Madhe.<sup>9</sup> Sulmet kibernetike ndaj Shqipërisë jo vetëm që dëmtuan funksionimin e qeverisë dhe tentuan të gërryejnë besimin tek institucionet financiare, por çuan edhe në rrjedhjen e një sasive të

---

<sup>7</sup>“Aktivitetet kulturore të Iranit në Shqipëri (Ballkani Perëndimor)”, 2021, gjendet në adresën <https://iramcenter.org/en/irans-cultural-activities-in-albania-western-balkan-453>, aksesuar më 31.03.2023.

<sup>8</sup> Higgins, A., 2023, “Një anëtar i vogël i NATO-s tronditet nga sulmet kibernetike të lidhura me Iranin”, gjendet në adresën <https://www.nytimes.com/2023/02/25/world/europe/albania-iran-nato-cyberattacks.html>, aksesuar më 23.03.2023.

<sup>9</sup>“Shqipëri-Iran: marrëdhëniet e prishura dhe lufta kibernetike”, 2022, gjendet në adresën <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-Iran-broken-relations-and-cyberwarfare-220532> aksesuar më 31.03.2023.

madhe informacioni konfidencial.<sup>10</sup> Irani i hodhi poshtë si të pabaza akuzat për kryerjen e sulmeve kibernetike kundër Shqipërisë dhe akuzoi qeverinë shqiptare se po vepronte me dritëshkurtësi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Po ashtu, Irani deklaroi se sulmi kibernetik u mbështet nga partitë që financojnë grupet terroriste.<sup>11</sup>

Një çështje konflikti mes Shqipërisë dhe Iranit është grupi Muxhahedeen El-Khalq (MEK), një grup opozitar iranian që strehohet në Tiranë. Grupi është i pranishëm në Shqipëri të paktën që nga viti 2013. Qëllimi i MEK-ut është të përmbysë qeverinë teokratike të Iranit.<sup>12</sup> Aktualisht, llogaritet se në Kampin Ashraf-3 të Shqipërisë, një kompleks shumë i fortifikuar dhe i mbrojtur me siguri private shqiptare, jetojnë rreth 3,000 anëtarë të MEK-ut.<sup>13</sup> E themeluar në vitin 1965 në Iran, në fillim kjo organizatë ishte kundërshtarë e politikave të dinastisë Pahlavi dhe mori pjesë në kryengritjen e vitit 1979 që solli në pushtet Ayatollah Khomeinin. Megjithatë, dallimet ideologjike çuan në ndarjen mes tyre, duke e detyruar grupin të mërgonte. SHBA-ja, duke njohur potencialin e grupit si instrument kundër regjimit iranian, e bindi Shqipërinë të strehonte anëtarët e MEK-ut, duke e vendosur kështu Tiranën në një konflikt diplomatik me Iranin. Kjo lëvizje, së bashku me sulmet kibernetike, ka përkeqësuar edhe më tej tensionet mes Iranit dhe Shqipërisë, me pasoja që mund të ndikojnë në vazhdimin e negociatave për programin bërthamor të Iranit.<sup>14</sup>

---

<sup>10</sup> "Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2022", 2023, gjendet në adresën <https://safejournalists.net/resources1/safe-journalists-report-indicators-on-the-level-of-media-freedom-and-journalists-safety-in-albania-2022-2/>, aksesuar më 31.05.2023.

<sup>11</sup> Deklaratë zyrtare, gjendet në adresën <https://en.mfa.ir/files/Pdf/0692576-newsExportfd543985fd47444f8b29720c824ae5b8.pdf>, aksesuar më 31.05.2023.

<sup>12</sup> "Si përfundoi Shqipëria në sulmet kibernetike të Iranit", 2022, gjendet në adresën <https://foreignpolicy.com/2022/11/08/albania-iran-cyberattack-mek-us-israel/>, aksesuar më 31.03.2023.

<sup>13</sup> "Si përfundoi Shqipëria në sulmet kibernetike të Iranit", 2022, gjendet në adresën <https://foreignpolicy.com/2022/11/08/albania-iran-cyberattack-mek-us-israel/>, aksesuar më 31.03.2023.

<sup>14</sup> "Shqipëri-Iran: marrëdhëniet e prishura dhe lufta kibernetike", 2022, gjendet në adresën <https://www.balkanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-Iran-broken-relations-and-cyberwarfare-220532> aksesuar më 31.03.2023.



## Shënime për metodologjinë

---

Për të monitoruar diplomacinë publike të Teheranit në Shqipëri përmes mediave të saj të sponsorizuara nga shteti, për qëllimin e kësaj analize, u qëmtua dhe u analizua në mënyrë cilësore një kampion i rastësishëm artikujsh të botuar në gjuhën shqipe në periudhën 27 qershor deri në 26 shtator 2022 nga Agjencia e Lajmeve Pars Today.

Artikujt u qëmtuan nga Pars Today duke përdorur SentiOne, një instrument online dëgjimi dhe analize që funksionon me inteligjencë artificiale. Për të identifikuar tematikat dhe mesazhet kryesore, u përzgjedh dhe u kodifikua një kampion artikujsh të botuar nga Pars Today për një periudhë tremujore.

Pas kategorizimit dhe etiketimit në një fletë pune Excel bazuar në tematika të nivelit të lartë, artikujt u analizuan në mënyrë cilësore për të kuptuar mesazhet e mediave me shërbim në gjuhën shqipe të sponsorizuara nga shteti iranian, bazuar në kategori të caktuara.

Përveç tematikave të nivelit të lartë që u identifikuan, u krye një analizë e artikujve bazuar edhe në tematikat me interes të listuara për të kuptuar sa më mirë mesazhet e Iranit për tema të veçanta, përfshirë ato për:

- Bashkimin Evropian;
- Të drejtat e njeriut; dhe
- Organizatën Mujahedin-e-Khalq (MEK).

## II. Gjetjet

---

Gjatë periudhës 3-mujore nga 27 qershori deri më 26 shtator 2022, Agjencia e Lajmeve Pars Today publikoi rreth 715 artikuj në gjuhën shqipe, të cilët iu nënshtruan analizës së përmbajtjes për të identifikuar tematikat kryesore të mbuluara nga mediat e sponsorizuara nga shteti iranian.




### Tematikat kryesore

---

Nëpërmjet analizës cilësore, tematikat më të përsëritura që trajtohen nga artikujt e botuar nga Pars Today në gjuhën shqipe janë: Nga bota, Gjeopolitikë, Ushtri dhe siguri, Politikë dhe kulturë iraniane si dhe Aktualitet shqiptar. Artikujt e tjerë mbulonin tema të tjera, si Ekonomia, COVID-19, Mjedisi dhe Të drejtat e njeriut.

## PËRQINDJA E TEMATIKAVE KRYESORE TË MBULUARA NGA PARS TODAY NË SHËRBIMIN SHQIP



Më poshtë jepet një përmbledhje e mesazheve kryesore që u evidentuan nga analiza cilësore e artikujve të botuar sipas çdo tematike kryesore të mbuluar nga shërbimi në gjuhën shqipe i Pars Today.

### **Nga bota**

Në kampionin prej 715 artikujsh të marrë në analizë nga Pars Today në shqip, të botuar gjatë tre

muajve, 260 artikuj ose 36.4 për qind e totalit i përkasin tematikës “Nga bota”. Nga gjithsej 260 artikuj të kësaj tematike, 112 prej tyre lidheshin me Rusinë. Shumica dërrmuese e artikujve për Rusinë fokusoheshin në agresionin e saj ndaj Ukrainës – 109 nga 112. Në përgjithësi, pasqyrimi i pushtimit rus të Ukrainës ishte në linjë me pikëpamjet dhe deklaratat e autoriteteve ruse, me përjashtim të disa rasteve të izoluara, kur flitej për viktimat, ose kur disa zhvillime politike/ diplomatike ishin në përputhje me mesazhin e diplomacisë publike të Iranit. Një shembull është deklarata e presidentit ukrainas Zelensky se Izraeli po tregohej indiferent ndaj agresionit të Rusisë ndaj vendit të tij. Rusia portretizohet në artikujt e Pars Today si aktor i fuqishëm global që po arrin sukses në luftë dhe si partner i besueshëm dhe një alternativë solide përballë SHBA-ve. Aktorë të tjerë të përshkruar pozitivisht janë Kina, Jemeni, Palestina, Iraku, Siria, Armenia dhe Uzbekistani. Aktorët e përshkruar negativisht në këtë tematikë janë Shtetet e Bashkuara, Arabia Saudite, Izraeli, Turqia, Britania dhe Japonia.

### Citim:

*“Ministri i Jashtëm i Rusisë tha se vendet perëndimore janë bërë shkak për humbjen e besimit tek institucionet dhe ligjet ndërkombëtare.”*

## Gjeopolitikë

Nga totali i artikujve që u analizuan nga hulumtuesit, 136 i përkisnin tematikës “Gjeopolitikë”, duke përbërë kështu 19% për qind të totalit të artikujve në kampionin e marrë në analizë. Artikujt e lajmeve të klasifikuara në këtë tematikë pasqyronin kryesisht deklaratat dhe qëndrimet e Iranit mbi ngjarjet ndërkombëtare në Lindjen e Mesme dhe në botë. Tre çështjet më të rëndësishme në këtë tematikë janë:

1. Qëndrimi i Iranit kundër ndryshimit të kufijve në rajonin fqinj (Azerbajxhan-Armeni)



2. Marrëveshje SHBA-Iran për armët bërthamore
3. Rivendosja e marrëdhënieve me Irakun

Në shumicën dërrmuese të deklaratave sulmoheshin Shtetet e Bashkuara, të cilat u cituan në 35 artikuj në këtë tematikë nga gjithsej 136, me përjashtim të rasteve kur qëndrimet e SHBA-ve ishin në përputhje me ato të Iranit, për shembull në lidhje me konfliktin mes Azerbajxhanit dhe Armenisë. Në këta artikuj sulmoheshin politikat e ndryshme të SHBA-ve ndaj Iranit, si, p.sh., sanksionet e Shteteve të Bashkuara të vendosura kundër Teheranit, apo zyrtarë të lartë amerikanë, përfshirë këtu edhe Presidentin amerikan Joe Biden.

### Citim:

*“Presidenti iranian Ebrahim Raisi tha se nuk ka plane të takohet me homologun e tij amerikan Joe Biden në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.”*

## Ushtri dhe siguri

Nga totali i kampionit të artikujve të Pars Today të marrë në analizë, hulumtuesit kategorizuan 106 prej tyre, ose 14.8 për qind, në tematikën “Ushtri dhe Siguri”. Shumica e artikujve në këtë tematikë mbulonin agresionin rus kundër Ukrainës. Nga totali prej 106 artikujsh të kësaj tematike, 32 prej tyre përshkruanin qëndrimin e Iranit ndaj zhvillimeve të ndryshme që lidhen me pushtimin e Rusisë. Në këta artikuj përçohet vazhdimisht mesazhi pro-Kremlinit për luftën, përfshirë këtu edhe kërcënimin për përshkallëzimin bërthamor të konfliktit dhe rreziqet që lidhen me furnizimin me armë për Kievin. Në artikuj jepeshin edhe përditësime të operacioneve ushtarake bazuar në burimet ruse, kryesisht të Ministrisë së Mbrojtjes të Rusisë. Në këtë tematikë, u pasqyruan edhe veprimet ushtarake të ndërmarra nga grupet e armatosura palestineze kundër Izraelit dhe, në një

masë të konsiderueshme, arrijtjet ushtarake të Iranit, veçanërisht stërviçjet e përbashkëta të zhvilluara me vende të tjera, si stërviçjet ushtarake “Vostok-2022” të mbajtura në Rusi, etj.

### Citim:

*“Rusia tha se ka goditur disa nga pozicionet e Ukrainës pas bombardimeve nga pala ukrainase të disa pikave pranë termocentralit më të madh bërthamor në Evropë, Zaporizhzhia.”*

Një nëntematikë e identifikuar në këtë kategori lidhet me luftën kundër terrorizmit nga Irani dhe aleatët e tij në Lindjen e Mesme - Iraku, Siria dhe Rusia. Në këtë nëntematikë u identifikuan 17 artikuj, të cilat mbulojnë sulmet terroriste nga Shteti Islamik dhe operacionet anti-terroriste nga Teherani dhe aleatët e tij, një deklaratë që kritikon praninë e forcave të vendeve perëndimore në Siri dhe pasqyrimin e shkëmbimit të pengjeve mes Shteteve të Bashkuara dhe talebanëve në Afganistan.

### Citim:

*“...ushtria dhe forcat e sigurisë irakiane janë ende në përpjekje për të pastruar plotësisht këto zona nga elementët terroristë.”*

## Politikë dhe kulturë iraniane

Hulumtuesit analizuan gjithsej 102 artikuj në kampionin që ishin të koduar nën tematikën “Politikë dhe shoqëri iraniane”, me pothuajse gjysmën e artikujve të kësaj kategorie që mbulojnë tema që lidhen me ngjarjet kulturore dhe fetare irakiane. Gjatë periudhës së marrë në analizë, shumë artikuj

u përqendruan në trazirat sociale të shkaktuara nga vdekja e Mahsa Aminit, një vajze 22-vjeçare iraniane, e cila vdiq në rrethana të dyshimta në një spital në Teheran, pasi u ndalua nga Patrulla e Veshjes, e njohur edhe si Policia e Moralit, me dyshimin se nuk mbante shami për të mbuluar kokën. Zemërimi për vdekjen e Aminit ndezi protesta të mëdha në Republikën Islamike, duke i krijuar një sfidë mjaft serioze regjimit iranian. Historitë e publikuara nga Pars Today që lidheshin me vdekjen e Aminit fokusoheshin vetëm në kundërprotestat e mbajtura në Iran. Protestuesit kundër qeverisë u portretizuan si të nxitur nga agjencitë e huaja të inteligjencës dhe Mujahedin-e-Khalq (MEK), grupi i opozitës iraniane që ka ngritur një bazë në Shqipëri. Në këtë tematikë pasqyroheshin lajme edhe për thirrjen e ambasadorëve të huaj për deklaratat ndërkombëtare që kritikojnë regjimin e Iranit. Në kampionin e artikujve pasqyroheshin lajme edhe për mesazhet e Presidentit të Iranit, Ebrahimi Raisi, për gjyqësorin, në lidhje me hetimin e shkaqeve të vdekjes së Mahsa Aminit.

### Citim:

*“Miliona njerëz kanë dalë në rrugë në kryeqytetin iranian Teheran për të denoncuar aktet e vandalizmit dhe përdhosjes së shenjtërive islame nga rebelët gjatë javës së kaluar pas vdekjes së një gruaje të re iraniane pasi ajo u dërgua në një stacion policie.”*

### Tematika të përzgjedhura

Përveç analizimit të tematikave të nivelit të lartë të artikujve të botuar nga Pars Today në gjuhën shqipe, hulumtuesit analizuan edhe përmbajtjen e lajmeve sipas tematikave të përzgjedhura që janë me interes, përfshirë këtu artikuj për Bashkimin Evropian, të drejtat e njeriut, dhe organizatën Mujahedin-e-Khalq Organization (MEK), që prodhoi konflikte diplomatike mes Tiranës dhe Teheranit.

## Bashkimi Evropian

Bashkimi Evropian, apo zyrtarë të ndryshëm të BE-së, ishin subjekt i 40 artikujve nga kampioni i analizuar nga shërbimi i Pars Today në gjuhën shqipe. Në artikujt e lajmeve që mbulojnë çështjet evropiane pasqyrohen rënia ekonomike e kontinentit, kriza energjetike, grevat dhe efektet negative të recesionit ekonomik/Covid-19, si rritja e shkallës së krimit, etj.

Pjesa më e madhe e lajmeve nën këtë kategori raportonin nga vendet e Bashkimit Evropian që kanë kundërshtuar vendosjen e sanksioneve kundër Rusisë ose ku kërcënimet e Rusisë për përshkallëzimin e konfliktit konsiderohen serioze dhe të rrezikshme. Hungaria ishte aktori evropian më kryesor që pasqyrohet më shumë në kontekstin evropian për qëndrimin e saj kundër sanksioneve ndaj Rusisë, për përplasjet me BE-në, për bashkëpunimin me Rusinë, etj.

### Citim:

*“Ministri i Jashtëm hungarez Peter Szijjarto tha se vendi i tij kundërshton çdo sanksion të ri kundër Moskës, veçanërisht në sektorin e energjisë, dhe i konsideron ndalime të tilla si “një vijë e kuqe e qartë”.*

## Të drejtat e njeriut

Nga Pars Today janë botuar në shqip gjithsej 11 artikuj në tematikën “Të drejtat e njeriut”. Pjesa më e madhe e artikujve të lajmeve ishin kritikë ndaj situatës së të drejtave të njeriut në Perëndim. Perëndimi u akuzua për standarde të dyfishta në trajtimin e të drejtave të njeriut, të ilustruar me raste nga abuzimet e të drejtave të njeriut të regjistruara në SHBA, Britani dhe Greqi. SHBA-të u akuzuan për përdorimin e torturës nga radhët e CIA-s dhe për heshtjen mbi burgun e Guantamos në Kubë. Në këta artikuj pasqyrohen edhe kritika për kushtet çnjerëzore në burgjet në Britani. Greqia

u veçua për shkeljen e privatësisë së qytetarëve dhe Arabia Saudite për burgosjen e aktivistëve. Ndër lajmet e tjera të kësaj kategorie ranë në sy raportimet e njëanshme dhe me gjuhë urrejtjeje ndaj shkrimtarit Salman Rushdie. Në gusht 2022, Rushdie u godit me thikë teksa ishte gati të mbante një fjalim në Chautauqua, Nju-Jork ku dhe humbi një sy nga ky sulm. Për dekada me radhë, Rushdie ka qenë subjekt i një fetvaje - dënim me vdekje i lëshuar nga udhëheqësi suprem i Iranit, për botimin e romanit të tij “Vargjet Satanike”.

### Citim:

*“Një gazetë greke zbuloi se Athina shkeli ligjet e demokracisë dhe spiunazhit në emër të mbrojtjes së sigurisë së mijëra njerëzve.”*

## Organizata Mujahedin-e-Khalq (MEK)

Nga kampioni i artikujve të publikuar nga Pars Today në shqip, hulumtuesit identifikuan 21 artikuj që pasqyronin raportime për Organizatën Mujahedin-e-Khalq (MEK). Teherani e quan grupin opozitar iranian, i cili ka gjetur strehë në Shqipëri, një organizatë terroriste dhe shpesh e akuzon për nxitje të trazirave në vend, si në rastin e protestave që pasuan vdekjen e Mahsa Amini. Artikujt e lajmeve pasqyruan edhe për përpjekjet e kundërzbulimit iranian për të penguar sulmet e supozuara terroriste të komplotuara nga MEK dhe simpatizantët e tij në Iran. MEK u akuzua edhe për nxitje të politikave anti-Tehran në Shqipëri dhe për dëmtim të marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Iranit.

Artikujt e botuar nga Pars Today pasqyrojnë kundërshtimin e Teheranit ndaj vendimit të Shqipërisë për të strehuar grupin opozitar iranian, për të cilin Teherani thotë se po komploton për të përmbysur me dhunë regjimin. Shumë prej artikujve të publikuar nga Pars Today pasqyrojnë reagimet e zyrtarëve iranianë, pas akuzave që Tirana i bëri Teheranit se ky i fundit qëndronte pas një sulmi

kibernetik që dëmtoi rëndë rrjetet digjitale të qeverisë shqiptare. Në këta artikuj, zyrtarët iranianë hodhën poshtë deklaratat e SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe se pas sulmeve kibernetike qëndronte Teherani. Në artikujt e analizuar tregoheshin histori edhe për të kaluarën e dhunshme të MEK-ut si grup i armatosur ku kjo organizatë përshkruhej me nota negative për marrëdhëniet e saj me anëtarët e bazës.

### Citim:

*“Organizata e Inteligjencës Gardës Revolucionare të Iranit njoftoi parandalimin e veprimeve të terroristëve të MEK dhe grupit monarkist për të kryer sulm me shpërthimin e bombave artizanale në qytetin Tabriz të provincës Azerbajxhani Lindor.”*

### III. Përfundime dhe rekomandime

---

Analiza e artikujve të Pars Today në gjuhën shqipe gjatë periudhës qershor - shtator 2022 nxjerr në pah disa paragjykime tematike në mesazhet e lajmeve. Është e qartë se Irani i shfrytëzon shumë mediat për të formësuar perceptimin publik në përputhje me interesat dhe ideologjinë e tij gjeopolitike. Mbulimi mediatik duket se anon dukshëm drejt Ruisë, duke e përfaqësuar atë si një aktor të suksesshëm global, veçanërisht në lidhje me konfliktin e Ukrainës, ndërsa vendet perëndimore shpesh portretizohen negativisht.

Vlen të përmendet se strehimi në Shqipëri i MEK-ut, një grup opozitar iranian, është një çështje e vazhdueshme konflikti, siç pasqyrohet në artikuj e marrë në analizë. Po ashtu, BE-ja, veçanërisht vendet që kundërshtojnë sanksionet ndaj Ruisë, është një tjetër tematikë që evidentohet më shpesh në artikujt e analizuar. Analiza nxjerr në pah edhe propagandën e Iranit për të drejtat e njeriut, me kritika që drejtohen kryesisht ndaj Perëndimit, pavarësisht trazirave të brendshme pas vdekjes së Mahsa Aminit. Në përgjithësi, analiza e medias sugjeron një përpjekje të qëndrueshme dhe strategjike nga Irani për të projektuar propagandën e tij të preferuar tek audiencia shqipfolëse.

Disa nga rekomandimet janë:

- *Thellimi i njohurive për mediat dhe informacionin:* Të thellohen njohuritë për mediat tek audiencia shqipfolëse për të promovuar konsum të kujdesshëm dhe kritik të lajmeve. Kjo lidhet edhe me edukimin e publikut për natyrën e mediave të sponsorizuara nga shteti, për të kuptuar kur mediat janë të njëanshme dhe rëndësinë e verifikimit të informacionit.
- *Diversifikimi i burimeve të lajmeve:* Të nxitet marrja dhe konsumi i lajmeve nga një gamë më e gjerë burimesh, përfshirë këtu ato pavarura dhe të njohura ndërkombëtarisht për standardet e tyre të gazetarisë. Në këtë mënyrë do të bëhej e mundur një pikëpamje alternative dhe një

perspektivë më e ekuilibruar për çështje globale dhe rajonale.

- *Transparenca në raportim*: Të punohet për nxitjen e transparencës së mediave, përfshirë këtu publikimin e burimeve të financimit, ekskluzivitetet dhe përfaqësimet e mediave ndërkombëtare, dhe çdo konflikt të mundshëm interesi që mund të ndikojnë në raportim.
- *Hulumtimi dhe monitorimi*: Të monitorohet dhe të analizohet rregullisht përmbajtja e mediave, veçanërisht e mediave të huaja të sponsorizuara nga shteti, për të evidentuar forma dhe njëanshmëri në raportime si dhe disinformimet. Të publikohen gjetjet për të informuar publikun, politikën dhe institucionet përkatëse për përpjekjet e mundshme propagandistike.
- *Mbështetja për gazetarinë e pavarur*: Të forcohet dhe mbështetet gazetaria e pavarur në vend në Shqipëri për të luftuar propagandën e njëanshme të mediave të huaja të sponsorizuara nga shteti. Në këtë mbështetje mund të përfshihen trajnimet, financimet dhe sigurimi i burimeve për të promovuar gazetarinë investigative dhe verifikimin e fakteve
- *Trajnime për sigurinë kibernetike*: Të shtohen investimet për trajnimet mbi sigurinë dhe infrastrukturën kibernetike për mediat dhe gazetarët.





---

# ANALIZË E MEDIAVE: PROPAGANDA E IRANIT NË GJUHËN SHQIPE



© Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative

Tiranë, 2023